

# *Ndikimi i anglishtes në gjuhën e mediave të Kosovës*

*Sejdi Sejdiu & Aida Alla\**

## **Abstrakt**

Qëllimi i këtij hulumtimi është pasqyrimi i ndikimit të gjuhës angleze në gjuhën e përdorur shqipe në mediumet e Kosovës. Gjuha shqipe gjithmonë është ndikuar nga gjuhët e tjera, duke përfshirë edhe ndikimin e pushtesve të ndryshëm gjatë historisë mbi popullin shqiptar. Gjuha angleze zë një vend të veçantë si gjuhë botërore apo ndërkombëtare. Përdorimi i saj ndikon në të gjitha gjuhët e botës, përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe, ku ndikimi i saj është bërë shumë i theksuar në njëzet vitet e fundit. Kjo ka ndodhur në sajë të hyrjes së pakontrolluar të anglicizmave në gjuhën shqipe dhe nevojës për emërtime të përshtatshme terminologjike si pasojë e zhvillimit të teknologjise. Fjalët e barazvlerëshme të shqipës tashme nuk përdoren as në medime e as në publik për arsye të prestigjit që gëzojnë fjalët angleze. Mungesa e fjalëve me barazvlerë të njëjtë është gjithashtu një arsye për të përdorur më shumë anglicizma. Sot, me gjithë angazhimin e lektorëve të gjuhës shqipe, medimet televizive dhe shtypi ditor janë me të theksuarat për përdorime të anglicizmave. Ky hulumtim merret me historikun, përdorimin, shkaqet, kohën dhe të ardhmen e anglicizmave në gjuhën shqipe.

**Fjalët kyç:** *gjuha shqipe, anglicizma, ndikim, përdorim, medime*

## **Hyrje**

Që nga ekzistenca e gjuheve, ato kanë huazuar fjalë nga njëra tjetra, disa më shumë e disa më pak varësisht nga prestigji i

---

\* *Sejdi Sejdiu (PhD), Kolegji AAB, email: sejdi.sejdiu@aab-edu.net & Aida Alla (PhD Cand.), Kolegji AAB, email: aida.alla@aab-edu.net*

tyre. Huazimi lind nga kontaktet njerëzore meqenëse njerëzit janë gjithmonë në lëvizje.

Në këtë aspekt, gjuha shqipe ka huazuar shume fjalë nga gjuhët e huaja dhe kjo varësisht nga pushtuesit e ndryshëm, shprehjet e të cilëve janë ende të pranishme në gjuhën shqipe. Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe ka marrë vrull në dy-tri dekadat e fundit dhe tashmë anglicizmat janë të pranishme pothuajse në çdo fushë të jetës. Zhvillimi intelektual i njerëzve sjell edhe zhvillimin e gjuhës, gjë që është edhe pasurim gjuhësor individual. Sot, huazimi është mënyra më e zakonshme e pasurimit gjuhësor. Fjalët e huazuara kryesisht mbulojnë ato emërtime për të cilat nuk ekziston një shprehje e përshtatshme në gjuhën marrëse. Një shembull mund të jenë fjalët që emërtojnë koncepte teknologjike, ato që emërtojnë veprime në sporte të ndryshme, shprehje politike apo ekonomike, etj.

Për nga kategoria gramatikore, gjuha shqipe ka huazuar nga anglishtja më se shumti emra. Sot, janë të zakonshme fjalët si: obligim (detyrim), atak (sulm), event (shfaqje), intervenim (ndërhyrje), asociacion (shoqatë), lider (udhëheqës), kompetencë (përgjegjësi), implementim (zbatim), koordinim (bashkërendim), departament (njësi), aprovim (miratim), progres (përmirësim), barrierë (pengesë), staf (ekipi), resurs (burim), akceptim (pranim), e shumë e shumë të tjera. Këto janë vetëm disa nga mijera fjalë të huaja që janë të pranishme në mediumet dhe në shtypin tonë.

Por, shtrohet pyetja, a duhet fjalët e mësipërme të jenë pjesë e gjuhës së medieeve në Kosovë kur për secilën prej tyre ekziston një fjalë me barazvlerë të njejtë? A kuptohen këto fjalë nga secila moshë? Përse përdoren dhe nga kush përdoren më së shumti? Këto çështje janë pjesë e këtij hulumtimi i cili është kryer në tri gazeta ditore dhe në katër medime televizive gjatë një periudhe kohore prej tre muajve, mars-maj 2015.

Anglicizmat sot janë të pranishme në pothuajse çdo gjuhën botë, por në mënyrë që ato të jenë pjesë e një gjuhe, duhet t'i nënshtrohen rregullave gramatikore, ortografike, fonetike dhe fonologjike në mënyre që të përshtaten sa me mirë në gjuhën marrëse. Fillimisht, para pranimit të fjalëve të huaja, duhet përpjekur që të gjejmë fjalët me barazvlerë të njejtë në gjuhën tonë dhe vetëm kur të gjitha mundësitë të shterën, atëherë të huazohen fjalët e huaja. Një mënyrë tjetër për të krijuar fjalë të reja është edhe përkthimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe.

Gjuha angleze është gjuha e dytë më e përdorur në mbarë botën. Fjalët e huaja sillen nga njerëz që e flasin një gjuhë tjetër. Njerëzit sot përdorin anglicizma për të treguar nivelin e tyre të lartë arsimor apo për të dëshmuar ndonjë vend pune të lartë. Fjalët e huaja me pas bëhen model nga njerëz të tjerë dhe në një kohë të shkurtër ato zenë vend në fjalorin e tyre. Një mënyrë për t'i shmangur fjalët e huaja është krijimi i tyre nga gjuhëtarët vendore. Por, meqë nuk ka kurrfarë nisme apo punë nga ta, atëherë gjuha jonë vërehet nga fjalë të huaja e që nganjëherë as që përdoren a kuptohen qartë nga masa e gjerë e shqipfolësve.

Janë pikërisht gazetarët, ekonomistët, politikanët, juristët e shumë e shumë të tjerë, të cilët flasin një shqipe të pacaktuar, të cilën vështirë se mund ta kuptojnë njerëzit e moshuar apo ata që nuk e kuptojnë gjuhën angleze. Në anën tjetër, përdorimi i anglicizmave në të folur dhe në të shkruar nuk e bën një njeri më intelektual se tjetri, përkundrazi, përdorimi i tyre vë në pah varfërinë e fjalorit të shqipes dhe varfërinë apo mangësinë e fjalorit të përdoruesve të tyre.

Gjuha shqipe duhet të zhvillohet dhe të mbrohet njëkohësisht me mekanizma aktive nga anglicizmat e pakontrolluara që po përdoren në vend të fjalëve me barazvlerë të njejtë.

Megjithatë, është e qartë se një numër i anglicizmave janë të nevojshme meqenëse emërtojnë koncepte të reja, të cilat janë kryesisht të fushës teknike, e për të cilat gjuha shqipe nuk ka fjalë të përshtatshme. Disa prej tyre janë: projekt, internet, kompjuter, e-mail, rekord, printer, koalicion, investim, eksport, import, radar, databaze, e të tjera.

Do të ishte ide e qëlluar sikur të kishim një fjalor të anglicizmave në mënyrë që të dinim dhe të merreshim me këtë dukuri që ka marr vull të madh.

### **Literatura**

Huazimet gjuhësore ndodhin kur dy apo më shumë gjuhë janë në kontakt me njera tjetrën. Në këto rrethana, është gjithmonë gjuha me e varfër ajo e cila merr fjalë a shprehje të reja nga gjuhët tjetra. Gjuhëtarë të shumtë, si Rasmus Rask<sup>1</sup>, Franc Bopp<sup>2</sup> dhe Jakob Grimm<sup>3</sup>, kanë shprehur mendimet e tyre për huazimet gjuhësore dhe përzirjen e gjuhëve. Ata kanë ardhur në përfundimin se fjalët mund të huazohen, por jo të ndryshojë struktura gjuhësore nga huazimet.

Hugo Schuchardt ishte i mendimit se nuk ekzistonte gjuhë e pastër, e papërzier apo e pa ndikuar nga ndonjë gjuhë tjetër dhe se për të huazimi ishte dicka krejt normale.<sup>4</sup> Ernst Windischparaqiti idenë se ndikimet gjuhësore ndodhin si rrjedhojë e zhvillimit të dygjuhësisë.<sup>5</sup> Ndryshe nga këta,

---

<sup>1</sup>Rask, R. *Essay on the Origin of the Ancient Norse or Icelandic Tongue*, Copenhagen, 1818

<sup>2</sup>Bopp, F. *On the conjugational system of the Sanskrit language - In comparison with that of Greek, Latin, Persian and the Germanic languages*. Germany 1816

<sup>3</sup>Grimm, J. *Deutsche Grammatik*, USA, 1819

<sup>4</sup>Schuchardt, H. *Contact Linguistics*, Berlin, 1884

<sup>5</sup>Windsich, E.A *Bibliography of English Etymology*, Published by the University of Minnesota Press, USA, 1897

Hermann Paul mendonte se për të ekzistuar apo mbijetuar një gjuhë, atëherë perzierja apo huazimi është i domosdoshem.

Në shekullin XX fjala përzierje u zëvendësua me fjalën huazim, meqenëse dukej më i përshtatshëm nga gjuhëtarët e asaj kohe. Uriel Weinreich më vonë përdori fjalën ndërhyrje (interference) meqë kjo i përshkruante më së miri ndikimet gjuhësore që i sillnin njerëzit që flisnin dy gjuhë. Interferenca dallohet tek shqiptarët kur në të folurit e tyre ka fjalë të huaja, apo gjuha e tyre është e përzier. Interferenca zakonisht është e dukshme gjatë mësimin të një gjuhe tjetër.<sup>6</sup>

Antoine Meillet nënën tjetër, e konsideronte huazimin e fjalëve si veprim të natyrshëm meqë shumica e gjuhëve mund të marrin elemente të gjuhëve të tjera të cilat mund të mos kenë jetë të gjatë.<sup>7</sup> Leonard Bloomfield shprehej se fjalët me së shumti huazohen me bartjen e kulturave mes popujve. Kjo, sipas tij, është difuzion kulturor meqë emertime të reja ndodhin gjatë këtij procesi.<sup>8</sup>

Si dy gjuhë indoevropiane, shqipja ka bërë huazime kulturore nga anglishtja meqë gjeografikisht nuk janë afër. Duke e ditur numrin e madh të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë që nga fundi i viteve të nëntëdhjeta dhe kur dihet se gjuha angleze ka shërbyer si *lingua franca* për komunikim mes shqiptarëve dhe të huajve, nuk do mend se është gjuha shqipe ajo e cila iu nënshtrua anglishtes për shkak të prestigjit që e gëzon kjo e fundit. Ky vërshim i anglicizmave në gjuhën shqipe nuk është kontrolluar nga asnjë institucion gjuhësor. Shumica e gjuhëtarëve sot shprehen se ndikimi i anglishtes në të gjitha gjuhët ekzistuese është si pasojë e globalizmit ndërkombëtar,

---

<sup>6</sup>Weinreich, U. *Languages in Contact: Findings and Problems*, Linguistic Circle of New York. No. 1. New York, 1963

<sup>7</sup>Millet, A. *Linguistique historique et linguistique générale*, Paris, 1921

<sup>8</sup>Bloomfield, L. *Language*, Allen and Unwin, London 1935

meqë anglishtja gjithnjë e më shumë po përdoret si *lingua franca*.

### ***Këndvështrimet e gjuhëtarëve shqiptarë për huazimet***

Kur bëhet fjalë për huazimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, është e vështirë të gjesh gjuhëtarë shqiptarë që të kenë një qëndrim të prerë pro ose kundër këtij fenomeni. Kjo ndodh për shkak të kompleksitetit që mbart në vetvete ky fenomen pasi vendos përballë dy ekstreme: pasurimin e gjuhës nëse këto prurje sjellin koncepte të reja, ose varfërimin e saj nëse futja e tyre në fjalorin e shqipes mbivendoset dhe për rrjedhojë lë mënjanë fjalën ekzistuese shqipe e cila më së miri mund ta kryej po atë funksion.

Profesor Vesel Nuhiu në librin e tij '*Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*', mendon se gjuha shqipe sot ka rrëshqitur nga norma në shumë drejtime dhe në shumë rrafshë, andaj nevojitet një riparim i thellë meqë ka dalë nga suazat e normës letrare. Është pikërisht përdorimi i anglicizmave, që është objekti i këtij studimi, që edhe profesor Nuhiu e sheh si një nga shkeljet më të mëdha të normës letrare.<sup>9</sup> Ai me tutje shprehet se gjuha duhet të zhvillohet, mirëmbahet qoftë me edhe me huazime, por të cilat duhet të jenë të arsyeshme në përputhje edhe me sistemin e drejtshkrimit dhe shqiptimin të gjuhës shqipe.<sup>10</sup>

Rami Memushaj është shumë i drejtpërdrejtë dhe tepër kritik kur shprehet se "Këto shëmti gjuhësore, që shpjegohen jo vetëm me kulturën e paktë gjuhësore, por edhe me një formim të përgjithshëm të mangët të njërëzve të përfshirë në ligjërimin publik, si gazetarët, politikanët, etj. mund të imitohen nga

---

<sup>9</sup> Vesel Nuhiu. *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Akademia e shkencave, Prishtinë, 2013.

<sup>10</sup>Po aty.

folësit e thjeshtë dheta barstardojnë gjuhën”<sup>11</sup>. Megjithatë, Prof. Memushaj pajtohet me faktin që gjuha duhet të pasurohet dhe modernizohet nëse është e nevojshme.<sup>12</sup>

Edhe personat me të njëjtën kombësi, sidomos të rinjtë, gjatë bisedave të tyre të përditshme përdorin shprehje por edhe fjali të plota në gjuhën angleze për të treguar statusin e tyre shoqëror dhe arsimor. Gjatë këtij procesi, fjalë të veçanta fitojnë një përdorim më të shpeshtë dhe me kalimin e kohës bëhen pjesë e fjalorit të tyre të përgjithshëm sikur të ishin fjalë të pastra shqipe. P.sh. “Kjo nuk është fair.”, në vend të “Kjo nuk është e drejtë”. “Ajo është një fashion lover.”, në vend të “Ajo është një adhuresë/ndjekëse e modës”.<sup>13</sup> Megjithatë, këto shprehje mund të konsiderohen si modizma, të cilat janë risi ose më shpesh risi huazimesh që kanë si tipar dallues përkohëshmerinë. Ato përhapen gjerësisht, ashtu si moda në një kohë të caktuar.<sup>14</sup> Eshtë tashmë e qartë për këdo se shqipja po hapët ndaj ndërhyrjeve të huaja, gjuhët po japin dhe huazojnë në ditët tona si kurrë ndonjëherë, dhe një dukuri e tillë ndodh për shumë arsye objektive; por kjo nuk duhet kuptuar sikur gjithçka që hyn duhet patjetër të pranohet dhe të kthehet në normë.

Çdo sjellje apo qëndrim është shprehje e emancipimit të kulturës, por në guackën e formimit të identitetit kulturor për të ligjëruar me të tjerët, individi fillimisht trashëgon dhe pastaj zgjedh, duke u përpjekur në vazhdimësi të japë kontribute për modelin e jetës. Ky model pranon edhe “modelin e zhvillimit të gjuhës”. Konstatimi ka bazën e vet logjike. Marrja e njërive

---

<sup>11</sup>Rami Memushaj. *Shqipja Standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë*. Botimet Toena. Tiranë 2011. fq. 110.

<sup>12</sup>Po aty.

<sup>13</sup>Lilo, R. *Mbi huazimet frënge në gjuhën shqipe*. Konferencë shkencore: Kontakte gjuhësore dhe kulturore mos shqipes dhe gjuhëve të tjera në 100 vjet (1912 - 2012), fq. 22.

<sup>14</sup> po aty, fq 27

terminologjike nga gjuhët e tjera nuk është tragjike për një gjuhë. E dëmshme është sidomos marrja e fjalëve dhe shprehjeve pa arsye, të cilat janë të mjaftueshme në fjalorët e përditshëm, apo mund të zëvendësohen me fjalë të moçme të shqipes, duke ju dhënë atyre kuptime bashkëkohore. Fjalformimet e reja në gjuhën shqipe realisht janë të pranishme.<sup>15</sup>

### ***Metodologjia e hulumtimit***

Siç edhe u përmend më sipër, gjuhët gjithmonë japin dhe marrin nga njëra tjetra për t'u pasuruar dhe kjo dukuri është duke u berë gjithnjë e më e pranishme në dakadat e fundit ku mundësia për t'u shprehur në mediumet e elektronike apo ato të shkruara, qofshin ato sociale apo jo, është rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Duke u nisur nga alarmi që ngrenë teoricienët e gjuhësisë shqipe, si dhe duke patur parasysh faktin që shumica e aktivitetit komunikues ndër njerëzve kryehet nëpërmjet mediumeve elektronike apo të shkruara, e konsideruam të nevojshme kryerjen e një hulumtimi të detajuar të prezencës dhe ndikimit të anglicizmave në mediumet e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, një arsye tjetër që legjitimon hulumtimit tone është fakti se, shumicën e rasteve, lajmet në shtypin shqiptar e kanë burimin në gjuhën angleze dhe përkthehen nga përkthyes amatorë ose nga vetë gazetari/rja të cilët shpesh here zëvendësojnë fjalën shqipe me barazvlerën në gjuhën angleze.

Hulumtimi ynë u përqendrua në mediumet më të rëndësishme televizive dhe ato të shkruara të Republikës së Kosovës, respektivisht në mediumet televizive RTK, KTV, Klan

---

<sup>15</sup>Mëniqi, K. *Anglicizat në ligjërimin*. Prishtina Press, Prishtinë, 2012.



Kosova dhe RTV21 si dhe në shtypin e shkruar, ku u shqyrtuan gazetat Koha Ditore, Zëri, dhe Kosova Sot duke mbuluar një periudhë kohore 30 vjeçare, nga viti 1998 deri në prill të vitit 2015. Hulumtimi u përqëndrua më shumë në artikujt që mbulonin politikën dhe kulturën pasi terminologjia politiko-diplomatike, për shkak të zhvillimeve të dakadave të fundit, ka pësuar më së shumti ndryshime dhe transformime, për kundër fushës së kulturës e cila dukej sikur deri diku i kishte bërë ballë joshjes së fjalëve të huaja, përkatësisht angleze.

Megjithatë, siç edhe do të vërehet në analizën e mëposhtme, gjuha në artikujt e kulturës është ndikuar po aq sa edhe politika. U pa e udhës të merrej në shqyrtim kjo periudhë kohore pasi pikërisht në vitet 90-të ka ndodhur futja masive e internetit dhe për rrjedhojë kemi edhe prurjet e para të cilat më vonë vërshuan gjithnjë e më shumë. Njëzetë studentë të Kolegjit AAB, Fakulteti i Gjuhës Angleze, vullnetarish u morën me fazën hulumtuese e cila zgjati tre muaj. Ata bashkërenduan punën e tyre në tre grupe dhe dolën me të dhëna shumë interante të cilat do të diskutohen dhe analizohen në vijim të këtij studimi.

### ***Të dhënave të hulumtimit***

Hulumtimet tona mbuluan një periudhë kohe 30 vjeçare me qëllim konstatiminin e dendurisë së këture huazimeve. Ashtu siç e kishim parashikuar, pikërisht në këtë periudhë kemi një numër gjithnjë e në rritje të anglicizmave. Shumë prej tyre, të futur në leksikun tonë për arsye që i përmendëm më sipër, janë fjalë të panevojshme pasi barasvlera e tyre në gjuhën shqipe ka të njëjtën vlerë semantike. Një tjetër grupim është ai i fjalëve të cilat e kanë pasuruar gjuhën shqipe me koncepte të reja të panjohura më pare ose i kanë shtuar fjalës egzistuese konotacione të cilat i përshtaten konteksteve të ndryshme.

Gjithashtu, një tjetër dukuri interesante gjuhësore është edhe përdorimi i ndajshesave fjalëformuese angleze në vend të atyre vendase. Në këtë kuptim, klasifikimin e shembujve të cilët do të demonstrohen në këtë studim do të identifikojnë natyrën e këtyre anglicizmave dhe pozicionin që ato zënë në leksikun e gjuhës shqipe. Ja vlen të përmendim se për asrye të mungesës së hapësirës, shembujt e mëposhtëm janë vetëm një munër i vogël krahasuar me gjetjet e bëra nga studentët e Kolegjit AAB.

### Liste me huazime të panevojshme nga anglishtja (shmangiet nganorma leksikore)

Anglisht	Huazimi	Shqip
Abuse	abuzim	shpërdorj
apply	aplikoj	zbatoj
agenda	axhenda	rend dite
cancel	kanceloj	anulloj
correct	korrektoj	korrigjoj
confidence	konfidencë	besim
consensus	konsensus	pëlqim
confuse	konfuzoj	ngatërroj
concentration	koncentrim	përqëndrim
dedication	dedikim	kushtim
event	event	aktivitet/ngjarje
perform	performoj	shfaq
performance	performancë	shfaqje
principle	princip	parim
leadership	lidership	udhëheqje
quality	kualitet	cilësi
quantity	kuantitet	sasi
observation	observim	vrojtim
implementation	implementim	zbatim
support	suport	mbështje
treatment	tretman	trajtim
Union	union	bashkim

**Lista e fjalëve me ndajshesa fjalëformuese të huazuara**

Anglisht	Huazimi	Shqip
Unfavorable	disfavorshme	i/e jovavorshme
demonition	demontim	çmontim
maltreatment	maltrajtim	keqtrajtim
multiethnic	multietnike	shumetnike
illegal	ilegale,	joligjore/e jashteligjshme
destabilization	destabilizim	jostabilizim
disinformation	disinformim	keqinformim
depolicization	depolitizim	çpolitizim
post-electoral	postzgjedhor	paszgjedhor
demilitarization	demilitarizim	çarmatim/çmilitarizim

**Lista e fjalëve të integruara në leksikun e gjuhës shqipe**

Anglisht	Huazimi
Mission	mision
context	kontekst
process	proces
execution	ekzekutim
contribution	kontribut
manipulation	manipulim
consultation	konsultim
proposition	propozim
transmit	transmetoj
internet,	internet,
computer	kompjuter,
e-mail	e-mail,
record,	rekord,
printer	printer,
coalition	koalicion,
investment	investim,
export	eksport
import	import

## ***Rekomandime***

Në kontekstin bashkëkohor të globalizimit dhe të komunikimit virtual është e pamundur që gjuhët të mos ndikohen nga njera tjetra, sidomos kur prezantohen koncepte të reja. Megjithatë, prurjet e reja pa kriter nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, dhe sidomos nëpërmjet shtypit, bëhen pengesë për zhvillimin dhe njësimin e normës. Nga ana tjetër, kemi një kontigjent fjalësh të përvetësuar në leksikon e shqipes, duke iu përshtatur natyrës gramatikore të saj. Grupi i fundit ka zënë statusin e pasuruesit të gjuhës. Megjithatë, gjuhëtari i shquar Eqerem Çabej është shprehur se “janë të gjitha mundësitë për një zëvendësim të fjalëve të huaja me fjalë vendi, dhe kjo pa bjerrje aspak të vlerës kuptimore të fjalëve”.

Nga të gjeturat e hulumtimit vihet në pah dukuria e shtimit të anglicizmave në gjuhën shqipe gjatë viteve të fundit e përdorur kryesisht nga mediet tona dhe për rrjedhojë nevojën që të merremi sa më parë me këtë dukuri. Asnjë gjuhë nuk është immune nga dukuria e ndikimit të gjuhëve të tjera. Por, ne nuk duhet ta përdorim këtë fakt si arsye.

Personat që thirren për të shqyrtuar apo mbrojtur gjuhën shqipe nga një dukuri e tillë, duhet që sa më parë të punojnë në këtë drejtim në mënyrë që të arrihet në një vendim për përdorimin apo përvetësimin e anglicizmave. Një komision i tillë madje do të duhej të ishte i vazhdueshëm ashtu siç është roli i komisionit të fjalorit të Oksfordit në Angli i cili i shqyrton të gjitha fjalët e reja apo të huaja dhe jep mendimin për përdorimin apo ndryshimin e tyre.

Në këtë kuptim, do të ishte e udhës që redaksitë e mediumeve në Kosovë të kryptojnë një komision kryesisht të përbërë nga gjuhëtarë, të cilët të mund të redaktojnë materialet para se ato të shtypen dhe të kenë një shpërndarje të gjerë në popullatë. Ngritja e një komisioni të tillë do të kontribuonte jo

vetëm në ruajtjen e normave gjuhësore por edhe për të orientuar zhvillimin e shqipes, pasi kjo e fundit ka nevojë për përmirësime të cilat shkojnë në një linjë me zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Gjithashtu, redaksitë e medimeve duhet të zbatojnë politika më të ashpra në lidhje me përzgjedhjen e gazetarëve, roli i të cilëve është shumë i rëndësishëm për përhapjen e fjalëve të cilat më vonë bëhen pjesë e pandashme e leksikut tonë dukë shtyrë gjithnjë më shumë në skajë fjalët shqipe.

### ***Përfundime***

Qëllimi kryesor i lajmit është që ta kuptojë secili qytetar, pa pasur nevojë për sqarime apo përkthime. Gjuha e përzier shqipe-angleze në mediumet tona është bërë vështirë e kuptueshme nga gjeneratat e vjetra meqë ata nuk janë rritur bashkë me teknologjinë bashkëkohore dhe kontaktet e tyre me gjuhën angleze kanë qenë shumë të pakta, të mosthemi nuk ka pasur fare të tilla.

Përdorimi i madh i fjalëve të huaja është rrjedhojë e nivelit të ulët të leximit në gjuhën amtare e që pasqyron në mosnjohjen e shumë fjalëve burimore shqipe. Madje sot ka shumë raste ku me qëllim përdoren fjalë të huaja me arsyetimin se tingellon me i shkolluar.

Nga ky hulumtim kemi arritur në perfundim se në disa fusha të lajmeve përdoren deri në 40% fjalë funksionale të huaja. Fusha e politikës, drejtësisë, ekonomisë janë fushat ku mediet tona përdorin pothuajse vetëm anglicizma, si për shembull: opozita, lidërsip, koordinim, realizim, online, degradim, devijim, kompani, performance, e tjera.

Me këtë hulumtim kemi dashur ta pasqyrojmë gjendjen e tanishme të përdorimit të anglicizmave në mediumet e Kosoves. Nga ajo që u tha më lart, vërehet qartë se anglicizmat

po hyjnë dhe po përdoren në masë të madhe në mediet tona. Duke e ditur se mediet janë burim i lajmeve dhe pasqyrim i gjuhës së një vendi, ne vijmë në përfundim se përdorimi i fjalëve burimore shqipe do të ndihmonte mediumet që lajmet e tyre të kuptoheshin nga të gjitha shtresat e njerëzve dhe si rrjedhojë gjuha shqipe nuk do të varfërohej gjithnjë e më shumë.

### ***Bibliografia:***

Bloofied, L. *Language*, Allen and Unwin, London 1935

Bopp, F. *On the conjugational system of the Sanskrit language - In comparison with that of Greek, Latin, Persian and the Germanic languages*. Germany 1816

Grimm, J. *Deutsche Grammatik*, USA, 1819

Lilo, R. *Mbi huazimet frënge në gjuhën shqipe*. Konferencë shkencore: Kontakte gjuhësore dhe kulturore mos shqipes dhe gjuhëve të tjera në 100 vjet. Tirana, GEER, 2013.

Mëniqi, K. *Anglicizat në ligjërimin*. Prishtina Press, Prishtinë, 2012.

Memushaj, R. *Shqipja Standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë*. Botimet Toena. Tiranë 2011.

Millet, A. *Linguistique historique et linguistique générale*, Paris, 1921

Nuhiu, V. *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013.

Rask, R. *Essay on the Origin of the Ancient Norse or Icelandic Tongue*, Copenhagen, 1818

Schuchardt, H. *Contact Linguistics*, Berlin, 1884

Weinreich, U. *Languages in Contact: Findings and Problems*, Linguistic Circle of New York. No. 1. New York, 1963

Windsich, E. *A Bibliography of English Etymology*, Published by the University of Minnesota Press, USA, 1897

**Lista e studenteve hulumtues në mbledhjen e të dhënave:**

1. Albana Gashi
2. Arben Shabani
3. Arber Xhemajli
4. Argjend Berisha
5. Arjeta Bllaca
6. Bardha Ajvazi
7. Blerina Sfishta
8. Dafina Hasanaj
9. Diana Aliu
10. Donika Iberdemaj
11. Fehmi Qerimi
12. Fortesa Kuqi
13. Gresa Xani
14. Nergis Gjinolli
15. Selda Savqi
16. Shkumbin Baxhuku
17. Uran Berisha
18. Valdet Bytyqi
19. Valeri Ahmeti
20. Valon Sejdiu